

FTESË PËR OFERTË

Emri: Milieukontakt Shqipëri
Adresa: Rr. 'Xhorxhi Martini', Pall. Teuta Konstruksion,
Shk.3, Ap.8 Kodi Postar 1017, Tiranë, Shqipëri
E-mail: office@milieukontakt.org
Afati i dorëzimit të ofertës: 21/08/2026

Milieukontakt Shqipëri po zbaton projektin projektit “*Forcimi i menaxhimit të mbetjeve përmes planifikimit dhe rregullimit vendor në Kavajë*”. Në kuadër të zbatimit të këtij projekti organizata kërkon të realizojë procedurën e prokurimit e thjeshtë për Sherbim ekspertize “**Ekspert për konsultimet publike në procesin e finalizimit të Planit të Menaxhimit të Mbetjeve**”

Kushtet për pjesëmarrje:

Të gjithë subjektet apo personat fizik të interesuar duhet të dorëzojnë ofertën e tyre sikurse parashikohet në kushtet e përgjithshme dhe specifike të kësaj ftese deri më **21 Gusht 2026**, në adresën e e-mailit: office@milieukontakt.org ose nëpërmjet postës në adresën Rr. 'Xhorxhi Martini', Pall. Teuta Konstruksion, Shk.3, Ap.8, Kodi Postar 1017, Tiranë, Shqipëri. Ofertat e dorëzuara dorazi nuk do të merren në konsideratë.

Specifikimet teknike:

Për këtë projekt, Milieukontakt Shqipëri do të zhvillojë procedurën e prokurimit për ekspertizë **Ekspert për konsultimet me publikun** sipas përshkrimeve në tabelën e mëposhtme.

Nr	Përshkrimi i ekspertizës	Takime	Çmimi/njësi Lekë	Çmimi total Leke (TVSH e perfshire)
1.	Konsultime me publikun	4		
	Totali			

PERSHKRIMI SHERBIMIT

Qëllimi i këtij shërbimi është ofrimi i ekspertizës për organizimin dhe realizimin e procesit të konsultimit publik në kuadër të hartimit të Planit Vendor të Menaxhimit të Mbetjeve dhe Rregullores së Menaxhimit të Mbetjeve për Bashkinë Kavajë.

Eksperti ose kompania e kontraktuar do të mbështesë procesin e përfshirjes së publikut dhe aktorëve të interesit, duke siguruar që mendimet, sugjerimet dhe komentet e tyre të merren në konsideratë për të finalizuar dokumentat.

Procesi i konsultimit do të realizohet në përputhje me legjislacionin shqiptar për njoftimin dhe konsultimin publik, si dhe me parimet e transparencës dhe pjesëmarrjes qytetare. Eksperti duhet të koordinoj dhe dokumentoj me një raport final 4 takimet konsultuese me aktorë në territorin e Bashkisë Kavajë.

DETYRAT

Eksperti/kompania do të realizojë këto detyra:

- Përgatitjen e metodologjisë së angazhimit të aktorëve të interesit;
- Identifikimin dhe koordinimin e pjesëmarrësve kryesorë, përfshirë përfaqësues të Bashkisë Kavajë, institucioneve publike, biznesit, organizatave të shoqërisë civile, komuniteteve lokale dhe grupeve të interesit;
- Organizimin dhe moderimin e takimeve konsultuese të nevojshme për mbledhjen e komenteve dhe rekomandimeve (Koordinimi do të bëhet ngushtësisht me stafin e Milieukontaktit dhe Bashkinë Kavajë, si dhe çështjet logjistike do të mbulohen nga MIA);
- Bashkëpunimin me ekspertët e Planit të Menaxhimit të Mbetjeve dhe të Rregullores së Menaxhimit të Mbetjeve për integrimin e komenteve dhe rekomandimeve të marra gjatë procesit të konsultimit;
- Sigurimin që procesi i konsultimit të jetë gjithëpërfshirës, transparent dhe në përputhje me kërkesat ligjore.

PRODUKTET QË DO TË DORËZOHEN

Në përfundim të shërbimit, eksperti/kompania do të dorëzojë:

- Metodologjia e konsultimeve publike dhe listën e aktorëve të përfshirë;
- Materialet e përdorura gjatë procesit të konsultimit (axhenda, prezantime, lista pjesëmarrësish, etj.);
- Raportin përfundimtar të konsultimeve publike, që përmbledh komentet, sugjerimet dhe rekomandimet e marra nga palët e interesuara;

KRITERET E PËRGJITHSHME

- Përvojë në projekte që lidhen me mjedisin, menaxhimin e mbetjeve, planifikimin vendor ose zhvillimin lokal;
- Njohje të legjislacionit shqiptar për njoftimin dhe konsultimin publik;
- Aftësi të mira komunikimi, moderimi dhe raportimi;
- Përvojë në bashkëpunimin me institucione publike, organizata të shoqërisë civile dhe komunitete lokale;
- Preferohen kandidatë me eksperiencë pune në Bashkinë Kavajë
- Eksperti duhet të përfshijë në ofertën e tij të gjitha kostot teknike, logjistike (transport, dieta, materiale, pajisje të nevojshme, etj.) dhe financiare.

Kualifikimet e ekspertit

Eksperti duhet të ketë:

- Diplomë universitare në shkencë sociale, administrim publik, mjedis, zhvillim lokal, komunikim ose fusha të ngjashme;
- Minimumi 3 vite eksperiencë profesionale në hartimin e raporteve dhe/ose aktiviteteve të ngjashme me këtë ekspertizë
- Aftësi të shkëlqyera në komunikim, moderim dhe koordinim me aktorë të ndryshëm.

Të gjithë subjektet apo personat fizik të interesuar duhet të dorëzojnë ofertën e tyre sikurse parashikohet në kushtet e përgjithshme dhe specifike të kësaj ftese deri më **21 Gusht 2026**, në adresën e e-mailit: office@milieukontakt.org ose nëpërmjet postës në Adresën Rr. 'Xhorxhi Martini', Pall. Teuta Konstruksion, Shk.3, Ap.8, Kodi Postar 1017, Tiranë, Shqipëri. Ofertat e dorëzuara dorazi nuk do të merren në konsideratë.

Operatori që ofron shërbimin me çmimin më të ulët dhe në përputhje me specifikimet teknike sipas ftesës, do të njoftohet për të nënshkruar kontratën. Pagesa e subjektit/personit fizik do të kryhet me transfertë bankare në monedhën Lekë, pas përfundimit të shërbimit dhe lëshimit të faturës përkatëse, ose si subjekt i tatimit mbi të ardhurat (15%) sipas legjislacionit shqiptar.

Në ofertën e tij, ofertuesi duhet të paraqesë të dhënat e plota të personit të kontaktit. Krahas ofertës financiare (aneks i ftesës), duhet të paraqesin edhe këto dokumenta:

- 1) CV ku të tregohen eksperiencat e mëparshme
- 2) Ekstraktin e QKB në rastin kur është subjekt, ose ID në rastin e personit fizik;
- 3) Numrin e llogarisë bankare.